



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 15

Datë: 06. 02. 2021. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Aktivitetet e ZRPPC-së:**
- 3. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Formulareve Zgjedhor, për zgjedhjet e parakoheshme për Kuvendin e Kosovës

4. Këshilli për Informim Publik

Informatë rreth aktiviteteve të Informimit Publik

5. Të ndryshme.

1. Hyrie: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: E hapi mbledhjen e 15-të të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. A ka dikush vërejtje në rend dite? Po urdhëro Artan!

Artan Asllani: Këshilli për informim public, e kem shty mbledhjen për mas KQZ-së, për shkak të kohës edhe e raportojmë në mbledhjen tjetër.

Valdete Daka: do t'w thotw, kjo pikë nuk është!

Alim Rama: Kemi një sygjërim nga sekretariati për këshillin e operacioneve zgjedhore në lidhje me pranimin e votave me postë.

Valdete Daka: Edhe ajo pra, hyn tek këshilli për operacione zgjedhore a po? Atëherë, kush është për këtë rend dite të ndryshuar? Fillojmë me aktivitetet e ZRPP-së.

2. Aktivitetet e ZRPPC-së

Yll Buleshkaj: Dje ka përfunduar afati për aplikim, për akreditim të vëzhguesve që vijnë nga subjektet politike dhe OJQ-të vendore, si rezultat kemi pas rreth 30.000 aplikacione. Do të jemi në shqyrtim të secilit aplikacion, asyeja pse nuk kemi paraqit numër para jush është se sikurse të gjitha gjërat edhe aty po kemi shumë duplikate si dhe mungesa të informatave. Pa përfunduar afati më nuk do të pranojmë aplikacione shtesë përveç se në qoftëse ndryshon diçka edhe KQZ-ja ndryshon ndonjë afatë. Për vëzhguesit nga subjektet politike dhe OJQ-të vendore ndërsa ende jemi duke pranuar aplikacione nga organizatat ndërkombtare, mediat dhe misionet diplomatike ndërkombtare.

Valdete Daka: Vazhdojmë me raportin e këshillave të KQZ-së.

3. Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Formulareve Zgjedhor, për zgjedhjet e parakoheshme për Kuvendin e Kosovës

Alim Rama: Këshilli për operacione zgjedhore do të shqyrtojë këto formulare të rekomanduara nga sekretariati. Në shumicën prej tyre ka pas rekomandim të plotë por është një formular të cilin nuk ka

rekomandim të plotë, kështu që shkojna të formulari I parë. Ky është formular për rezultatet preliminare në të cilin këshilli në mënyrë unanime e mbështet, edhe ky formular u përdorë për herë të parë në zgjedhjet e 2019-së, ndihmon në përshpejtimin e shpalljes së rezultateve preliminare. Sekretariati na konfirmon se cilët janë personat përgjegjës për implementimin e kësaj kontrate, që me e pas përgjegjësi secili që të bënë këtë lëshim. Se na ende nuk e dina saktësisht kush ka qenë përgjegjës për lëshimin që ka ndodh në zgjedhjet e kaluara, por kaniher duhet me pas përgjegjësi kështu që kemi kërkuar në këshill. Ky është formulari I përputhjes së rezultateve deri sa kemi pajtim, masanej kalojna tek ai tjetri. Këto dy ska pas kurfarë vërejtje në këshill, në mënyrë unanime I rekomandoj. Edhe FPR-ja të dyjat kanë qenë aty, këtu ka pas vërejtje d.m.th ky këshillin e rekomandon me 4 vota për, 1 kundër edhe unë veq e kisha arsytu votën kundër, edhe bëjë kërkesë po ashtu që ende sepse tash këtu është qështje më teknike e hapsirat e shprazura, tash kanë mundësi ta bëjnë atë lëshimin e bartjes së rezultateve të kandidatëve. Në qoftë se në zgjedhjet e kaluara ka qenë lëshim teknik, edhe ka pas një përqindje shumë të madhe të vendvotimeve që janë rinumëruar për shkak të lëshimit teknik me formularë sepse nuk ka pas hapsira për partinë e parë, PLE se në qoftë se atëher nuk ka pas hapsirë ku me shkrujtë edhe bartja ka fillu ma posht. Tash në këtë rast në mënyrë të qëllimshme mundet me u krijua kjo huti në orën 12 ose 1 të natës kur plotësohen këto formular mbase numërohen të gjitha votat e kandidatëve. Këtu regjistrohen edhe numërohen sipas rregullës të gjitha votat për të gjithë kandidatët përfshirë edhe pytjen që ka qenë nëpër media për Albin Kurtin, secilat vota numrohen edhe regjistrohen këtu. Tash problemi prej këtij formulari bëhet bartja tek formulari I rezultateve të kandidatëve, qoftëse nuk ka hapsirë ose hapsirat janë në midis të mbyllura nuk ka hapsirë atëherë rreziku, që gabim ose lëshim teknik tek komisionerët është shumë I madhë. Kështu që unë kërkojë ende që edhe tek formularët e rezultateve të kandidatëve të lihet hapsira qysh është 1 këtu të mbetet edhe 1 atje e shpraztë, 6 të mbetet e shpraztë sepse bartja bëhet në mënyrë mekanike nga komisioni.

Valdete Daka: Kush është për këtë formular? Kush është kundër? Me 2 vota kundër, aprovohet formulari. Vazhdojmë me formularin tjetër !

Alim Rama: Tash vjen në pyetje ajo se qka ka thanë kolegu Kurteshi në mbledhjen e kaluar. Kjo është vendim I qëllimshëm që të krijohet huti në bartje teknike të punës së KQZ-së. Me këtë vendim, me këtë votë kështu, KQZ-ja në mënyrë të qëllimshme krijon ose tenton me pas sa ma shumë rinumërimë sepse na këtu qarazi kemi me pas lëshime teknike në bartje. Edhe Z.Kurteshi që e ka përmend herën e kaluar, këtu ka përgjegjësi penale sepse, vendimi është i qëllimshëm edhe ti je në rregull që me kriju vendime të qëllimshme.

Valdete Daka: Unë jam në rregull përderisa janë të gjithë kandidatët të cilët janë të certifikuar, janë në këtë formular. Unë nuk shoh kurgjo të pa ligjshme, zbatimi i asaj qka na e kemi aprovua vet.

Alim Rama: Kur ka ardh te broshurat për shkak të këtij lëshimit ju keni qenë kundër rekomandimit të sekretariatit d.m.th neve edhe rekomandimet teknike duhet me I interpretu për qëllime politike edhe ju si kryesuese nuk është dashtë me pas qëndrim politik është dashtë 100% me e përkrah sekretariatit. Dje jeni anku që jeni pjesë e sulmeve. Qëllimshëm ju po doni me kriju telashe ne proces edhe secili duhet me pas përgjegjësi penale për votën që e bënë, që krijon probleme. E kjo është me qëllim me kriju probleme teknike në proces zgjedhor. Unë nuk them se votat kanë me u numëru, në formularin tjetër votat do të numërohen edhe regjistohen secila votë. Se është një kampanjë nëpër rrjete sociale jo nuk votohen, jo nuk numërohen, jo është e pa vlefshme. Secila votë për secilën do parti është votë e vlefshme edhe votohet deri në 5 kandidatë duke u përfshirë në rastin tim, sepse nuk dua me e përmend partit tjera edhe votën j por në qoftëse formularët krijohen asi lloji që me u kriju bartje teknike atëherë është përgjegjësia e këtij institucioni edhe vendimet që po I marrim.

Valdete Daka: Po urdhëro Eshref!

Eshref Vishi: Unë, apsolutisht nuk po pajtona me Z.Rama. Me gjithë diskutimin të cilin e pati rreth pikave të rendit të ditës të cilat u miratuan. Ne duhet të sigurojmë procesin zgjedhor, se ai do të rrjedh normalisht dhe duke respektuar rregullat dhe procedurat zgjedhore. Procesi si I tillë do të mbikqyret në kuptim të rregullsis të mbarvajtjes së tij nga KQZ. Miratimi I formulaëve edhe i FPR, FRK dhe fletë llogaritjet për votat e kandidatëve mendoj se janë në përputhje me rregulla zgjedhore dhe siguron një proces të drejtë, të sigurt dhe të ligjshëm në ditën e votimit e sidomos gjatë procesit të numërimit të votave dhe evidentimit të rezultateve. Është shqetësuese që ka subjekt politik që bënë thirrje edhe tek votuesit për veprimet të cilat bien ndesh me dokumentet e miratuara nga KQZ. Vlerësoj se duhet respektohet dhe zbatohet ligji për zgjedhjet e përgjithshme, rregullat zgjedhore e sidomos kodi I mirësjelljes për subjektet politike, mbështetsit e tyre dhe kandidatët. I cili kod, i mbanë përgjegjës që mos të bien ndesh me veprimet të ndaluara gjatë fushatës dhe heshtjes zgjedhore. I vetmi autoritet që ka obligim ligjor, që ti informojë drejt votuesit për mënyrën e votimit është KQZ. Lëshimet që i përmend Z.Rama duhet ti menaxhojë subjekti I tij politik. Bëmë thirrje mediatike për veprimin ndryshe nga rregullat të cilët ne po I miratojmë. Ne kemi miratu broshurën dhe nga broshura deri vonë të gjitha këto formularë nuk duhet të jenë në shpërputhje me broshurën e miratuar. Ne po ecim drejt edhe po I respektojme procedurat dhe ligjin.

Sami Kurteshi: Unë e kuptoj krejt këtë përpjekje, tash me I dezorientu votuesit edhe komisionerët edhe vëzhguesit. Kjo është fakt ata qka e kemi thane nuk e tërheqim. Nuk ka subjekte anonime politike është LVV që po I pengon, nuk e kam atë problem fundi fundit secili subject politik kaqyr me zënë dikun në farë vendi që ka me mbetë dikun po dita e votimit do të vjen, votimet do të bëhen. Ne me shumë dëshirë po e presim ditën e votimit edhe ne do ta dim qka do të ngjanë se me qenë detyrë e një institucioni shtetëror që votimin me e lehtësu sa ma shumë që të mundet, në aspektin teknik, në aspektin administrative. Mos të bëjë asnjë shkelje ligjore, nuk muj me pas përgaditje të mëparshme, të madhe gjithkush po veprimet e qëllimshme për ti hutuar vëzhguesit, komisionerët gjatë bartjes së rezultateve po shihen hapur. Ne megjithatë e presim me shumë dëshirë 14 shkurtin, 14 shkurti do të ngjajë edhe do të vjen një moment kur do të dalin edhe rezultatet. Qfardo përpjekje ne jemi të bindur që një rezultat ka me dal shumë I mirë, punë e këtij institucioni kishte me qenë që krejt qështjet të rregullohen me kohë që votuesit, ata të zotë e votës së tyre mund ta shprehin votën e tyre edhe ajo votë e tyre të reflektohet në të gjitha dokumentet zyrtare të institucioneve. Kjo përpjekje nuk është, janë bë përpjekje për të bërë diqka kundër kësaj ne I kemi kuptuar këto. Shumë shpesh nuk përmenden emrat, nuk përmendet subjektet është LVV është strumbullari, është emri I Albin Kurtit që po I pengon, nuk zhduket. Kjo krejt qka është tu ngja është fushatë e zgjedhjes. Strumbullari I problemit, stylia e problemit është frika edhe është urrejtja ndaj një subjekti edhe ndaj një njeriu. Po kjo që po bëhet me formular, me bartjen kjo është veprim I qëllimshëm për hutimin e votuesve të komisionerëve edhe të vëzhguesve. Nëse kjo qenka fushatë merreni si të doni, ne po e themi qartë, hapur, konkret me emra, me gjithqka.

Alim Rama: Unë, jam duke ju referuar ligjit sepse Eshrefi ka thanë një të pa vërtet e të pa saktë. Për një jurist qysh u prezantu këtu besoj që e ka lexu ligjin për zgjedhje. Ligji për zgjedhjet, votuesi pajiset me një fletëvotim pikën 110.4 vetëm për zgjedhjet dhe e shënjom atë me votën që e lexuat ju në reklama, me votën për një subject politik dhe po ashtu mund të shënoj atë me vota deri me 5 kandidatë. Është ligji për zgjedhje, fletëvotimi është neutral për të gjithë, I ka 28 subjekte një anë, I ka 110. Puna e komisionerëve është me I numëru secilën votë prej 1 deri 110 si për listën e VV që I ka 110 kandidatë e në të cilën 3 I ka hjek sistemi sepse është sistemi I korruptuar. Sikurse edhe parta , VAKAT mbase e kam përpara 42 a se di sa janë, d.m.th 1 deri 42 edhe personi kur e voton VAKAT ose partin turke që e kam këtu për rreth, që ka po ashtu rreth 40-të edhe voton 50 ose 60 në regjistër duhet me u shënu. Se puna e komisionerit është me bë bartje një për një, hutimi që po tenton kolegu Vishi përballë me prezentu, është frika prej krejt qka po ndodh. Te njeri pik së pari duhet me u referu. Qysh kemi kalu në zgjedhjet e kaluara me 11 vota tu luftu

për secilën votë që qajo është ajo frika, se tash as që nuk i vjen rradha me ardh në QNR se ska me pas as 5%. Vendimet e qëllimshme të KQZ-së në kundërshtim me sekretariatit. Sekretariati për telefonatën e secilit aplikantë nga mërgata ka thënë është vështirë e realizueshme, nuk besojna e keni shti sekretariatit me të një operacion, i cili u provua atë që ka kemi thanë na që ka qenë në kundërshtim. Ata kanë thanë na nuk jemi të sigurtë, skemi kapacitete. Sepse ka të bëjë me vendimet e KQZ-së në kundërshtim të rrethanave teknike, në qoftëse teknikisht nuk është e mundur me I thirr 150.000 a sa kanë qenë? Jemi duke diskutu për rekomandimet e sekretariatit.

2.1 evidentoj dy shkelje të cilat po bëhen brenda kësaj sale të KQZ-ve. Një është, rezistenca e zbatimit të vendimit të gjykatës supreme që është obligim ligjor për me I zbatuar KQZ-ve. Nëse nuk I zbaton, bëne vepër penale. E dyta, është presioni I vazhdueshëm që vendimet partiake po bëhen rrenohen Brenda KQZ-ve edhe kjo nuk ndodh.

Valdete Daka: Po udhëro Rifat!

Rifat Krasniq: Vetëm ne jemi këtu në institucion, në KQZ, dhe ne e kemi në rend të ditës! Ne, nuk jemi ardh këtu me i ndëgju ligjeratat e LVV. Nuk është ky vend parlamenti, ose tubim me i bwrw reklama VV-së!

Valdete Daka: Asnjëherw, institucioni i KQZ-së nuk ka qenë më I plotizum. Mirë, kush është për këtë formularë? A ki tjetër formularë Alim?

Burim Ahmetaj: Sekretariati, me autorizimet nga KQZ-s, është në procedurën e pranimit të pakove të fletëvotimeve të cilat do të vijnë nga votuesit të cilët janë jashtë vendit, pra votat përmes postës. Miëpo, në bazë të autorizimeve, procedurën me të cilën jemi ngarkuar si sekretariat për ta zbatuar, vështirë është e realizueshme edhe për kundër faktit edhe e falenderojmë Postën e Kosovës që ka shpreh gadishmëri që në bazë të vendimit të KQZ-ve të na ofrojë mbështetjen. Mirëpo, në praktikë kemi hasur në vështersi e sidomos me postat kurierë me postat e shpejta që proceduralisht këto shërbime të Postave të shpejta në rast se dërgohen me postën kryesore të Kosovës, të gjitha këto shërbime duhet të paguhen dhe postat e shpejta për kundër faktit që adresë e kanë fahun postal është një procedurë e postave të shpejta që përmes sistemit Traking e dërzojnë të dorëzuesi I fundit që I bien në këtë rast personi I autorizuar nga KQZ-ve që do të bëjë pranimin e të gjitha këtyre pakove ose këtyre zarfeve. Pra në praktikë ajo se qka jemi autorizu si sekretariat ta realizojmë si procedurë, vështirë që do të mund të realizohet përmes stafit tanë d.m.th

praktikisht të gjitha ato zarfe nëse dërgohen në postën e Kosovës do ti duhen ti nënshtohen procedurës së taksës. Është fjala për postat e shpejta. Dje gjatë gjithë ditës kemi pasur komunikim me Postën e Kosovës, po ashtu edhe me postën e shpejtë edhe kemi ardh sidomos me postën e shpejtë më një përfundim që opsioni I vetëm, më I mirë për të gjitha palët është që pakot ose zarfet me fletëvotimet të cilat vijnë me postën e shpejtë që në mënyrë gjeniale duhet të vlejë edhe për postat e tjera të shpejta është që të mbahen në pritje në objektet e postave të shpejta. Dhe sekretariati ta caktoj një kohë të caktuar që është e përshtatshme për të gjitha palët, që të bëjë bartjen e këtyre zarfeve deri në vendin ku do të ruhen. Kjo I bjen që edhe në bashkëpunim edhe me postën e shpejtë e në këtë rast del edhe postat e tjera që ti mbajnë deri një kohë të caktuar që e kemi parapa që të jetë ora 15:00 e pasditës sepse sipas procedurav të gjitha postat e shpejta diku deri në orën 13:00 - 13:30 të ditës janë dërgesat e fundit që përfundojnë nëpër secilën postë. Dhe nga kjo kohë deri në kohën e paraparë është koha e mjaftueshme që ti përgadisnin këto pako në mënyrë që ti dërzojnë në KQZ-ve dhe KQZ-ve bashke me eskortin e Policisë dhe në prani të vëzhguesve, me personin e autorizuar të shkojë në objektet e këtyre postave dhe ti tërheq pakot, ti dërgojë në vendin e mbajtjes. Kjo është opsioni pothuajse I vetëm I realizueshëm dhe për këtë ju kërkujmë mirëkuptim KQZ-ve të na autorizojë neve si sekretariat dhe ta kryejmë këtë procedurë në këtë formë. Përndryshe autorizimi për procedurën që e kemi pasur nga dita e djeshme, vështir apo po thuhet është e pa realizueshme. Pra kërkujmë mirëkuptimin e juaj dhe të vazhdojmë me këtë procedurë, të shkojmë nëpër secilën postë të shpejtë me protokoll, ti marrim dhe ti dërgojmë në objektin apo në vendin e mbajtjes për të gjitha këto zarfe.

Artan Asllani: E para kisha kërkuar që, për këto postat e shpejta që po I përmendni, e para të shikoni se cilat janë në të vërtetë të regjistruara nuk janë fiktive dhe ti shikoni ato që ka kohë që veprojnë edhe që e dimë që marrin posta dmth për kompanit me renome ajo tashmë dihet. Pra, siguroni që të shkoni pra në vetë ngjarje në qendrat e pranimit të tyre dhe ti merrni ata dhe ti njoftoni ashtu si ti bëni për Postën e Kosovës edhe për qendrën tranzitore ta bëni njëjtë dhe njëllor dhe me keto kompani që ti njoftoni të gjithë vëzhguesit, ti njoftoni Policinë e Kosovës dhe bashkë me përgjegjësin d.m.th të KQZ-së ti merrni ato. Mirëpo, në të njëjtën kohë kordinoni edhe në lidhje me kohën se kur është e përshtatshme edhe për ata po edhe për neve si KQZ-së, dhe ta keni të njëjtin orarë, pra të ditës, të dini pak a shumë se ku a në cilën qendër do të shkoni gjatë një dite.

Burim Ahmetaj: Aktualisht deri më tani janë 3 posta të cilat janë të regjistruara dhe ato janë , DHL, TNT, Express dhe U5. Mund të ketë edhe ndonjë postë, por sido që të qoftë do ti gjërmojmë edhe do të shohim

se vjen nga një postë tjetër të shohim në këtë aspekt. Mirpo këto janë zyrtarishtë ato të cilat operojnë në territorin e Kosovës ndërsa sa i përket procedurës gjithqka do të bëhet në mënyrë protokollare duke e caktuar kohën se kur do të shkohet, do të njoftohen vëzhguesit me përcjellje të Policisë dhe të gjithë e dimë se postat e shpejta punojnë në sistemin Tracking që d.m.th personi i autorizuar në këtë rast nga KQZ-ve momentin që e bënë pranimin teknik të secilit zarf apo të secilës pako atëherë përmes sistemit evidentohet edhe secili votues nga jashtë që i ka dërgu përmes postave të shpejta, nëpërmjet sistemit Tracking i konfirmohet se posta është dërguar në destinacionin e kërkuar që në këtë rast KQZ-ve si institucion përmes personit të autorizuar i pranon të gjitha këto posta. Pra do ta kemi edhe personin e autorizuar që do ta bëjë pranimin teknik të secilit zarf, në mënyrë që të gjithë dërguesit ta kenë edhe statusin që posta ka arritur në destinacionin e kërkuar.

Sami Kurteshi: Unë, pajtohem që të letësohet sa të jetë, sa është e mundur bartja e të gjitha këtyre postave edhe fletëvotimeve. Kërkojë nga sekretariati, vetëm që vëzhguesit edhe nëse duan përfaqësuesit e partive politike të këtyre subjekteve politike ta vëzhgojnë procesin që të njoftohen me kohë, që këto zarfa apo pliko si do që i quani. Natyrisht që është obligim edhe i joni që secili zarf i dërguar, në qfarodo mënyrë të mbërrij këtu me formën e rregullt, se qysh janë këto shërbimet postare se këto shërbimet postare e kanë një përvojë të gjatë. Unë kërkojë që në qdo moment, të njoftohen vëzhguesit edhe përfaqësuesit e partive politike, ata të cilët janë të interesuar që ta vëzhgojnë procesin.

Sami Hamiti: Edhe unë e mbështes pasi që është ajo që e kërkuam ne dje, sepse është e vërtet që KQZ-ja në kuptimin institucional ka marrëveshje me Postën e Kosovës. Unë desha të ndërlihem me atë që e tha Arianiti. Qashtjen e postave të cilat janë posta të shpejta dhe që janë të regjistruara përveq DiAelli apo cilat janë ato, edhe 3-4 posta që janë ndërkombtare që operojnë. Një sygjërim që të hjekën të gjitha dilemat, ju e dini që egziston vendimi i gjykatës supreme, votat edhe të jo kushtetutës më vonë. Votat që mbërrijnë në KQZ-së si votim jashtë vendit secila kliko duhet ta ketë vulën e postës nisëse. Për me u hjek të gjitha dilemat ato vijnë, ato duhet ta kenë vulën e postës nisëse për tu aprovuar se sepse nëse nuk ka vulë të postës nisëse, ju e dini se qka ka ndodhë me një kontigjent që kanë ardh të tilla në zgjedhjet e 2019-tës. Dhe pikërisht vendimi në gjykatën supreme është marr për ato liko të cilat nuk e kanë vulën e postës nisëse. I vetmi element që duhet shërbimi votues jashtë vendit të ta sheh tli mirfillë vendimet edhe aktgjykimet që kanë ndodhë edhe ligjin d.m.th votat që niset, aplikacioni që niset, klikoja që niset duhet ta ketë vulën e postës nisëse nga vendi ku është dërgua.

Arianit Elshani: Unë, vetëm se dua ta përsëris faktin se qka është bisedua në takimin e KOZ-it. Bëhet fjalë për sigurinë e mbërritjes së votës, mbërritjes së klikove me vota në faktë dhe vendi ku do të vendosen votat është kërkuar që të jenë kamerat e vendosura sado që të egziston një kamer. Prap se prapë ka edhe zotim prej vetë administratës që do të vendosin kamerat edhe brenda edhe jashtë. Kjo është kërkesa edhe unë besoj që do të kryhet me përpjekmëri.

Alim Rama: Une e kam pas këtë sygjërim edhe dje por në rregull është. Të sigurohet regjistri për të gjitha pranësve që kanë ardh në KQZ në fund të procesit dhe ajo një kërkesë që komunikon me dije.. regjistrimi I numrit të pakove në fund të procesit dhe të mbahet siguri deri në fund të këtij procesi.

Arianit Elshani: Raport ditor d.m.th, edhe nga shërbimi votues edhe nga sekretariati të kem raporte ditore për marrjen e pakove d.m.th nga shërbimi postar. Si antarë I KQZ-së I kem këto raporte ditore.

Burim Ahmetaj: Sekretariati I mur masat edhe jemi në procesin të vendosjes së kamerave brenda hapsirës ku do të mbahen, kështu që jemi në proces, kështu që e kemi gjetë zgjidhjen dhe do ti vendosim kamerat brenda. Dera e jashtme është e vëzhguar nga kamera, nga Ministria e Infrastructures mirpo, e kemi një protokoll I kemi shërnjetat e sigurisë sa herë të hapet e të mbyllet dera do të shënohet në protokoll. Po ashtu, do ti kemi edhe regjistrat dhe protokollat e dërgesave nga secila postë dhe ndoshta do të mund të vijmë në një moment kur do të na duhet ndoshta më shumë se një herë brenda ditës të shkojmë të marrim dërgesa. Mirpo për këtë do të ju njoftojmë me kohë për secilin proces, qoftë KQZ-ve, qoftë vëzhguesit po ashtu edhe në përcjellje të eskortës, kështu që nëse kemi fluks të madh apo numër të madh të zarfeve apo të dërgesave postare atëher do të na duhet me shku më shumë se një herë brenda ditës. Mipro koha të silën e kemi parapa aktualisht është koha 15:00 për të gjitha postat dhe pastaj që i bjen në intervalin prej orës 15:00 deri në ora 16:00 që ti marrim dërgesat, mirpo në rast se do të paraqitet nevoja do të na duhet dy herë ose tri herë me shku me I marr.

Alim Rama: Në lidhje me këto ka qenë në sygjërim që KQZ-ja të ia dërgon Postës së Kosovës që me I leju vëzhguesit, me vëzhgu procesin. Edhe jo me prit gjithë KQZ-në por edhe e para me pas vëzhgim në pahun postar edhe në QTP...